

MENDIM MOSPAJTUES

I.

1. Në këtë rast autori nuk pajtohet me vendimin e shumicës së trupit gjykues për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor sipas nenit 357.1 të KPP-së, as me vendimin paraprak për përfundimin e procedurës së provave sipas nenit 348 të KPP-së. Hë për hë, shqyrtimi gjyqësor ka përfunduar dhe ka pasur arsye të sqarohet rasti dhe të plotësohet procedura dhe të merren sqarimet sipas nenit 359.1 të KPP-së. Pavarësisht nga provat e paraqitura nga palët, Kodi i Procedurës Penale i Kosovës ia mundëson qartë Gjykatës iniciimin dhe zhvillimin e procedurës së provave *ex officio* ashtu që Gjykata do të kishte qenë në gjendje të dëgjoj dëshmitarë tjerë, t'i ekzaminoj provat dokumentuese, të angazhoj dhe dëgjo ekspertë dhe/ose t'i bashko procedura me procedura të mëhershme kundër të pandehurve të njëjtë. Kjo nuk del vetëm na dispozitat e cekura më lartë por theksohet qartë edhe në nenin 239.4 të KPP-së. Ashtu siç kërkohet në mënyrë eksplicite në nenin 7 të KPP-së jo vetëm që kishte me qenë e drejt por edhe obligim i Trupit Gjykues të mbledh prova për vërtetimin e plotë të rastit duke vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të besueshme faktet, si ato fajësuese ashtu edhe shfajësuese. Në rastin konkret, pa një përpjekje për sqarimin e rastit përtej asaj çfarë është paraqitur në Aktakuzë, nuk do të kishte pasur një arsyetim për zhvillimin procedurës për gjatë shumë viteve.
2. Në të njëjtën kohë, Gjykata do të kishte qenë në gjendje të ndaloj marrjen e provave të panevojshme dhe jorelevante sipas nenit 258. 2 të KPP-së dhe do të fokusohet në provat vendimtare në fazë shumë më të hershme, ashtu siç ceket hapuri në nenin 300 të KPP-së.
3. Autori më tej nuk pajtohet as me vendimin për refuzimin e kërkesës së mbrojtjes së datës 20 tetor 2017 për t'i dhënë kohë adekuate për ta përgatitur rastin që rezultoi me vendimin e të pandehurve për të mos dhënë dëshmi në shqyrtimin gjyqësor. Këso mënyre të pandehurit ishin privuar nga mundësia ta shtjellojnë rastin dhe t'i zbardhin pretendimet kundër tyre. Për pasojë, në fund të këtyre procedurave të gjata pretendimet kundër të pandehurve janë po aq të pasqaruara siç kanë qenë në fillim të shqyrtimit gjyqësor. Prandaj Trupi gjykues për shumicën e akuzave ka konstatuar se nuk janë provuar përtej dyshimi të bazuar se të pandehurit kanë kryer aktet për të cilat akuzohen, por Trupi Gjykues nuk ka qenë në gjendje t'i vërtetoj faktet dhe të bëj një shënim të saktë se çka ka ndodhur dhe çfarë nuk ka ndodhur në lidhje me veprat e supozuara dhe në lidhje me hetimet penale.

II.

4. Autori nuk pajtohet me të gjeturat e shumicës së Trupit Gjykues se aktet me të cilat ngarkohen të pandehurit në pikën I nuk përbëjnë veprën penale të Krimin të Organizuar sipas nenit 364 (1.1) të KPP-së, që bazohet në supozimin se vepra penale e krimin të organizuar kërkon veprën bazë e cila është e ndëshkueshme me dënim minimal me së paku 4 vite burgim.

5. Nocioni *krim i rëndë* në nenin 283 të KPK dhe nenin 274 KPPK i referohet çdo veprë penale për të cilën mund të shqiptohet katër a më shumë vite burg, pra çdo veprë me dënim maksimal prej së paku 4 vite. Së pari, interpretim gramatikor i shprehjes ‘ i dënueshëm deri me 4 vite burgim’ jo vetëm në anglisht por edhe në shqip e serbisht e mbështet këtë interpretim. *I dënueshëm* i referohet *mundësisë së shqiptimit* të një dënimi prej 4 a më shumë vite burgim.
6. Veç kësaj, ligjvënësi ka synuar në mënyrë të qartë të përfshij si vepra bazë për krim të organizuar ato vepra penale që marrin një *dënim maksimal* katër a më shumë vite burgim. Duke inkorporuar dispozitat për krim të organizuar ligjvënësi kosovar ka ndjekur miratimin e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare në një fushë të rëndësisë transnacionale. Veprimi i Përbashkët i BE që e konsideron vepër penale pjesëmarrjen në një organizatë kriminale” i datës 21 dhjetor 1998 ashtu edhe Konventa e KB kundër Krimit të Organizuar Transnacional” i datës 15 dhjetor 2000 i përcakton krimet e rënda bazë në kuadër të krimit të organizuar si *çdo vepër penale që mund të dënohet me 4 ose më shumë vite burgim*. Ndonëse formulimi në versionin e gjuhës angleze të KPK/KPPK ka një dallim të lehtë, nuk ka arsye të supozohet se legjislatori kosovar ka synuar të devijoj në mënyrë drastike nga këto standarde evropiane dhe ndërkombëtare dhe kështu t’i përjashtoj praktikisht të gjitha këto vepra penale nga përgjegjësia si krim të organizuar që përbën fenomenin më të rëndomtë në sektorin e krimit të organizuar.
7. Po ashtu interpretimi i katër viteve si kusht për dënim maksimal është jurisprudencë edhe në Kosovë. Vendim i sipërcekur (i shumicës) i Gjykatës Themelore të Prizrenit ka qenë një përjashtim kurse në shumë raste gjykatat kanë konstatuar se çdo vepër penale me dënim maksimal prej së paku 4 vite mund të jetë një krim serioz në suaza të nenit 283 të KPK-së ose nenit 274 të KPPK-së.¹ Edhe gjatë procedurës fillestare në dy lëndët në shqyrtim Kryetari i trupit gjykues si edhe gjyqtarët e kolegjit të Gjykatës së Apelit kanë konfirmuar akuzat dhe nuk kanë ngre dyshime se aktet me të cilat ngarkohen të pandehurit janë vepra penale dhe në veçanti se veprat bazë të këtyre akuzave janë *krime të rënda* në kuptim të akuzave të krimit të organizuar.

Anëtare e trupit gjykues
Jennifer Seel

Procesmbajtëse
Alexandra Popova

¹ p.sh. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 19 dhjetor 2016, Nr Plm.Kzz. 178/2016; Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 2 tetor 2012, Nr Ap-Kz nr 61/2012; Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 18 janar 2012, Ap-kz nr 255/2011; Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 14 gusht 2012, Pkl-Kzz nr 109/2012; Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit i datës 14 maj 2015, Nr PAKR 215/14; Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës nr PAKR 1282/12 i datës 28 maj 2014; Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit i datës 6 nëntor 2015, PAKR 52/14; Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës i datës 6 janar 2015, Nr PKR 18/14; Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prizrenit i datës 6 shtator 2013, Nr P 123/13; Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës i datës 17 qershor 2011, Nr 244/2010.